

## Juridiksioni

### Ambasada

## Paisja me Pasaporte Biometrike dhe karte Identiteti

Shtetasit Shqiptare me banim ne SHBA, apo në nevojë për këtë shërbim, mund të Aplikojnë për Pasaporte dhe Kartë Identiteti vetëm pranë Konsullates Shqiptare në Nju Jork.

Ju mund të kontaktoni Zyren Konsullore në Nju Jork si në vijim:

Adresa:

Konsullata e Shqipërisë Nju Jork

320 East, 79 Street

Neë York NY

Tel: 212 255 7381

e-mail: [consulate.newyork@mfa.gov.al](mailto:consulate.newyork@mfa.gov.al)

web: [www.albanianconsulate.usa](http://www.albanianconsulate.usa)

Ambasada Shqiptare, zyra konsullore në Uashington DC nuk e ofron këtë shërbim në asnjë rast.

### **Çfarë duhet të bëjnë shtetasit kur humbin ose duhet të zëvendësojnë pasaportën e udhëtimit?**

Kur shtetasit shqiptarë humbin pasaportën, duhet që menjëherë të bëjnë denoncimin në organet policore të vendit përkatës dhe të njoftojnë Përfaqësinë diplomatike ose konsullore në atë vend.

Për t'u ri pajisur me pasaportë, shtetasit që e kanë humbur atë, duhet të veprojnë njëllë sikurse dhe shtetasit e tjerë që kërkojnë të pajisen nga e para me pasaportë, duke shtuar këtu dhe depozitimin e dokumentit denoncues.

## Dokumente të tjera

### Lejekalimi

Leja e Kalimit është një dokument udhëtimi ndërkombëtar që zëvendëson provizorisht pasaportën dhe i lejon mbajtesit të saj të udhetojë për në shtetin e tij për t'u pajisur me dokumentacionin e nevojshëm. Ka një vlefshmeri prej një (1) muaji dhe mundëson vetëm hyrjen në Shqipëri. Për të dalë sërish nga kufinjte shqiptarë çdo shtetas duhet të pajiset me pasaportë të vlefshme.

Lëshimi i Lejës së Kalimit bëhet me prezencën e personit të interesuar para Konsullit.

Dokumentat/veprimet shoqëruese:

1. Prania e të interesuarit
2. Pasaporta e skaduar ose një certifikatë lindje
3. Dokument me foto ID ose kartë shqiptare e identitetit
4. Denoncimi i humbjes së pasaportës (në se ka humbur apo është vjedhur)
5. Dy foto të të interesuarit.

Pagesa e shërbimit është 45 dollarë

Bëhet përjashtim për prezencën e shtetasit, në rastet kur ai:

Është i ndaluar, arrestuar ose burgosur. Në këtë rast kërkesa bëhet nga autoritetet kompetente për të huajt në vendin pritës që merren me përmbarimin e veprimeve të kthimit në atdhe të personave në gjendje të parregullt;

Për arsye të forta shëndetësore, nuk mund të paraqitet në përfaqësi. Në këtë rast kërkesën e bëjnë familjarët ose për këtë paraqesin deklaratë përfaqësimi dhe dokumente të tjera bindëse.

Kërkesa për pajisje me lejekalimi e personave të mitur deri në 16 vjeç bëhet nga dy prindërit ose njëri prind, me pëlqimin e prindit tjetër. Pëlqimi jepet nëpërmjet një deklarate noteriale.

Për të miturin me një prind ose me kujdestar, kësaj kërkesë i bashkëlidhen dokumente që konfirmojnë kujdestarinë mbi fëmijën.

Personi i mitur, (i sapolindur) për t'u pajisur me lejekalimi, paraprakisht duhet të jetë regjistruar në zyrën përkatëse të gjendjes civile në vendin ku ka lindur dhe dokumenti shoqërues duhet të jetë i legalizuar në përputhje me

legjislacionin në fuqi. Shtetasi që aplikon për Leje kalimi duhet të plotësojë **Formularin LK1**.

### **Lejekalimi për transportimin e trupit në Shqipëri, në raste vdekjeje**

Me kërkesën e të interesuarve, të afërmeve apo nëpërmjet agjencisë funerale zyra konsullore lëshon lejen për transportimin në Shqipëri, të trupit të shtetasit të vdekur. Leja e kalimit për transportimin e kufomës në Shqipëri mund të lëshohet vetëm për shtetasit shqiptarë.

Leja për transportimin e trupit lëshohet mbi bazën e paraqitjes së aktit të vdekjes dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të lëshuara nga autoritetet vendase. Ky dokumentacion në SHBA përgatitet nga Agjensite Funerale

Ky dokument nevojitet vetëm për riatdhesimin e kufomës

**Për regjistrimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri** duhet të disponohet çertifikata origjinale e vdekjes me vulën Apostille. Kjo certifikatë duhet të depozitohet për regjistrim në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri ku ka qënë i regjistruar i vdekuri.

Për lëshimin e Lejes së Kalimit për rastet e Vdekjeve është e nevojshme që t'i dërgohen zyrës konsullore dokumentat e mëposhtëm:

- Pasaporta e personit të vdekur.
- Çertifikata e vdekjes
- Dokumentat e Agjencisë funerale që vertetojnë, përgatitjen e trupit bashkëngjitur dhe çertifika mjekësore që nuk disponon semundje ngjitëse etj.
- Nje zarf i parapaguar për dërgimin e Lejes së Kalimit dhe dokumentacioni.